

Më 17 shkurt mbahet protestë në mbrojtje të çlirimtarëve që po mbahen në Hagë



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

KOSOVA FTOHET NGA TRUMPI QË TË JETË PJESË E BORDIT TË PAQES PËR GAZËN



Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka njoftuar të mërkurën se ka pranuar ftesë personale nga udhëheqësi amerikan, Donald Trump, që ta përfaqësojë vendin në Bordin e Paqes, “si anëtare themeluese”. Osmani ka theksuar se ashtu si Amerika që solli paqe në Kosovë, sot Kosova qëndron si aleat i palëkundur i saj për ta çuar paqen më tej. “Historia i mban mend ata që bëjnë hapa të guximshëm në ndërtimin e paqes - dhe ne jemi gati”, është shprehur Osmani pas pranimit të ftesës nga Trumpi

ZGJEDHJET E 28 DHJETORIT 2025, ÇFARË NDODHI NGA VOTIMI DERI TE RINUMËRIMI I PLOTË?

F. 3



IKD-ja: VEPRIMET E AGRON QALAJT PO BLOKOJNË ZBATIMIN E REFORMËS NË KPK

F. 7



TRUMP NË DAVOS: KËRKOJ NEGOCIATA TË MENJËHERSHME PËR TA BLERË GRENLANDËN

F. 2

INSTITUCIONET E ZBATIMIT TË LIGJIT DHE SIGURISË NË KOSOVË FORCOJNË AFTËSITË PËRMES TRAJNIMIT NGA DEA E SHBA-së

F. 6

TRIM TËRNAVA EMËROHET KRYESHEF I RI I KOSTT-it

F. 8

“PRISHTINA 2030” SJELL RISI NË LOJËRAT MESDHETARE ME SPORTE TË REJA

F. 10

RENOVA

PUTZ

Maqedoni
Xhepçisht –Tetovë
Gurëz-Ferizaj

Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289

E-mail: renova@mt.net.mk

NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE

INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

FABRIKA E LLAQEVE

STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji
BIZNESI

www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA

VIENNA INSURANCE GROUP

SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË

Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency

Endrit Shaqiri
+38344685122

Internet Website,
Marketing...

TRUMP NË DAVOS: KËRKOJ NEGOCIATA TË MENJËHERSHME PËR TA BLERË GRENLANDËN

DAVOS, 21 JANAR - Presidenti amerikan, Donald Trump po merr pjesë në Forumin Ekonomik të Davosit në Zvicër më 21 janar. Fjalimi i udhëheqësit amerikan në Davos mbahet në kohën e tensioneve me udhëheqësit evropianë lidhur me Grenlandën. Ai e nisi fjalimin me Amerikën, me saktë, me ekonominë amerikane, duke e lavdëruar atë. “Ekonomia po lulëzon”, tha ai. ShBA-ja thotë se dëshiron ta ketë kontrollin mbi territorin autonom të Danimarkës, për arsye të sigurisë kombëtare. Ai theksoi para liderëve botërorë në Davos së Shtetet e Bashkuara kërkojnë bisedime të menjëhershme për ta blerë Grenlandën. “Kërkoj negociata të menjëhershme për ta blerë Grenlandën”, tha ai. Trump thotë se asnjë vend në botë përveç Shteteve të Bashkuara nuk mund ta sigurojë Grenlandën. Trump këmbëngul se “nuk kam nevojë ta përdor forcën, nuk dua ta përdor forcën, nuk do të përdor forcën”. E vetmja gjë që ShBA-ja po kërkon, thotë ai më pas, është

“një vend i quajtur Grenlandë”. Trump tha se Evropa “nuk po shkon në drejtimin e duhur”, duke shtuar se “pjesë të Evropës janë bërë të panjohura”. Sipas tij, “përqendrimi në energjinë e gjelbër dhe migrimi masiv po e lëndojnë Evropën”. “E dua Evropën, dua ta shoh atë mirë, por nuk po ec në drejtimin e duhur”. Duke iu përgjigjur pyetjeve Trump thotë se “jemi afër” një marrëveshjeje për t'i dhënë fund luftës mes Rusisë dhe Ukrainës. Ai tregon se do të takohet me presidentin ukrainas, Volodymyr Zelensky, më vonë gjatë ditës. “Besoj se jemi në një pikë ku ata mund të bashkohen dhe ta bëjnë marrëveshjen. Dhe, nëse nuk e bëjnë, janë budallenj”, thekson Trump, duke iu referuar liderëve të Rusisë dhe Ukrainës. Trump tani e kthen vëmendjen te lufta në Ukrainë, duke thënë se NATO-ja do të ndihmojë për ta ndaluar atë. “Duhet ta ndalojnë atë luftë, sepse po vdesin shumë njerëz, po vdesin pa nevojë”, thotë ai, duke shtuar se presidenti rus Vladimir Putini dhe ai ukrainas Volodymyr

Zelensky duan të arrijnë marrëveshje. Trump thotë se ShBA-ja do t'i ndihmojë Evropën dhe NATO-n në këtë drejtim dhe se e vetmja gjë që ai po kërkon është “një copë akulli”, duke iu referuar Grenlandës. Ai e quan këtë kërkesë të vogël krahasuar me atë që ShBA-ja i ka dhënë NATO-s. Ai thotë se ShBA do të jetë 100% përkrah NATO-s, por nuk është i sigurt nëse aleatët do t'ia kthejnë favorin.

Shefi i NATO-s thotë se po punon për zgjidhjen e çështjes së Grenlandës

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Mark Rutte, deklaroi më 21 janar se mënyra e vetme për zgjidhjen e krizës rreth Grenlandës është “diplomacia e matur”, duke shtuar se po punon “në prapaskenë” për këtë çështje. Kreu i aleancës ushtarake perëndimore, i cili po merr pjesë në Forumin Ekonomik Botëror në Davos, refuzoi të komentojë lidhur me synimet e presidentit amerikan, Donald Trump, për ta



marrë nën kontroll këtë ishull, duke theksuar se diplomacia është më e rëndësishme sesa deklaratat publike. “Ju siguroj se për këtë çështje po punoj në prapaskenë”, tha shefi i NATO-s gjatë një paneli në Davos. Ai përsëriti se nuk do të prononcohet publikisht, pasi, sipas tij, “e vetmja mënyrë për ta zgjidhur krizën është diplomacia e menduar mirë”. Rutte është udhëheqësi i vetëm që deri më tani ka konfirmuar se do të takohet me Trumpin në margjinat e forumit në Davos të Zvicrës. Duke folur në panel, Rutte theksoi se Shtetet e Bashkuara

mbeten të përkushtuara ndaj aleancës, por shtoi se Amerikës i duhet “një Evropë e sigurt dhe një Arktik i sigurt”. Ai theksoi se, sa i përket Arktikut, pajtohet me presidentin amerikan. “Duhet ta mbrojmë Arktikun nga ndikimi rus dhe kinez”, tha Mark Rutte. Ai po ashtu kërkoi që Evropa dhe ShBA-ja që mospajtimet për Grenlandën t'i shpërqendrojnë nga lufta në Ukrainë, që Rusia e nisi afër katër vjet më parë. “Përqendrimi në Ukrainë duhet të jetë prioriteti ynë kryesor, është thelbësor për sigurinë evropiane dhe të ShBA-së”, u shpreh ai.

BE-ja SYNON KUFIZIME TË REJA NDAJ EKSPORTIT TË TEKNOLOGJIVE PËR DRONËT NË IRAN

BRUKSEL, 21 JANAR - Bashkimi Evropian ka propozuar ndalimin e eksportit të më shumë teknologjive për dronë dhe raketa drejt Iranit, pas shtypjes vdekjeprurëse të protestuesve, tha presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen. “Evropa qëndron në solidaritet të plotë me gratë dhe burrat e guximshëm të Iranit, të cilët po rrezikojnë jetën e tyre për të kërkuar liri për veten dhe për brezat e ardhshëm”, shkroi von der Leyen në X. “Sot, ne po propozojmë ndalimin e eksporteve shtesë të



teknologjive jetike për dronë dhe raketa”, shtoi ajo. Von der Leyen tha se BE-ja po

përgatit gjithashtu sanksione të tjera ndaj atyre që janë përgjegjës për “shtypjen e

vazhdueshme dhe brutale” të protestave që tronditën Republikën Islamike. Protestat disajavore ishin sfida më e madhe me të cilën është përballur udhëheqja iraniane në vitet e fundit. Shkalla e plotë e pasojave nga shtypja është bërë e ditur gradualisht, pasi tash e 11 ditë Irani vazhdon të jetë në terro total pa internet dhe komunikim. Pavarësisht vështirësive në qasjen në informacion, organizata joqeveritare Iran Human Rights thotë se ka verifikuar se 3.428 protestues

janë vrarë nga forcat e sigurisë. Sipas mediave lokale dhe vëzhguesve, autoritetet kanë vazhduar me arrestime pas valës së demonstratave, pavarësisht trysnisë ndërkombëtare. BE-ja tashmë ka sanksionuar disa qindra zyrtarë iraniane për shtypjen e lëvizjeve të mëparshme protestuese dhe për mbështetjen e Teheranit për luftën e Rusisë në Ukrainë. Billoku ka ndaluar gjithashtu eksportin drejt Iranit të një sërë komponentësh që mund të përdoren në prodhimin e dronëve dhe raketave në vend.

Japonia rindez centralin bërthamor më të madh në botë, 15 vjet pas katastrofës së Fukushima

TOKIO, 21 JANAR - Centrali bërthamor Kashiwazaki-Kariwa i Japonisë, më i madhi në botë, rifilloi punën të hënën për herë të parë që nga katastrofa e Fukushima në vitin 2011, tha kompania që e drejton atë, pavarësisht shqetësimeve të vazhdueshme publike. Rinisja fillimisht do të përfshijë vetëm një nga shtatë reaktorët e centralit, i cili është më i

madhi në botë për sa i përket kapacitetit të përgjithshëm gjenerues. Rinisja e punës u bë në orën 19:02 (ora lokale, 12:02 GMT), tha për AFP-në Tatsuya Matoba, një zëdhënës i Tokyo Electric Power (Tepco). Guvernatori i prefekturës qendrore-perëndimore të Niigatës, ku ndodhet centrali, dha miratimin e tij muajin e kaluar për rinisjen, pavarësisht faktit se opinioni publik është i

ndarë për këtë çështje, sipas një sondazhi të kryer nga prefektura në shtator, 60% e banorëve ishin kundër rinisjes, krahasuar me 37% që e mbështetën atë. Një ditë më parë, disa dhjetëra protestues, kryesisht të moshuar, kishin sfiduar të ftohtin për të demonstruar në dëborë dhe pranë hyrjes së centralit, në bregdetin e Detit të Japonisë, kundër rinisjes së tij.



KOSOVA FTOHET NGA TRUMPI QË TË JETË PJESË E BORDIT TË PAQES PËR GAZËN

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka njoftuar të mërkurën se ka pranuar ftesë personale nga udhëheqësi amerikan, Donald Trump, që ta përfaqësojë vendin në Bordin e Paqes, “si anëtare themeluese”. Osmani ka theksuar se ashtu si Amerika që solli paqe në Kosovë, sot Kosova qëndron si aleat i palëkundur i saj për ta çuar paqen më tej. “Historia i mban mend ata që bëjnë hapa të guximshëm në ndërtimin e paqes - dhe ne jemi gati”, është shprehur Osmani pas pranimit të ftesës nga Trumpi

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 21 JANAR - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka njoftuar të mërkurën se ka pranuar ftesë personale nga udhëheqësi amerikan, Donald Trump, që ta përfaqësojë vendin në Bordin e Paqes, “si anëtare themeluese”. “Jam thellësisht e nderuar nga ftesa personale e presidentit Trump për të përfaqësuar Republikën e Kosovës në Bordin e Paqes, si anëtare themeluese, krah për krah me ShBA-në në misionin për një botë më të sigurt”, shkroi Osmani në Facebook.

Ky bord pritet të mbikëqyrë udhëheqjen e Rripit të Gazës, pasi Shtetet e Bashkuara ndërmjetësuan një marrëveshje armëpushimi mes Izraelit dhe Hamasit - grupit palestinez të shpallur organizatë terroriste nga Uashingtoni dhe Bashkimi Evropian.

Osmani tha se udhëheqja e guximshme e ndërton paqen dhe nuk flet thjesht për paqen, dhe kjo është, sipas saj, pikërisht ajo që po bën presidenti amerikan “nëpërmjet kësaj iniciative historike”.

Presidentja Osmani tha se ShBA-ja solli paqen në Kosovë dhe

Kosova sot është aleate “e palëkundur e saj për ta çuar paqen më tej”. “Historia i mban mend ata që bëjnë hapa të guximshëm në ndërtimin e paqes - dhe ne jemi gati”, shkroi ajo.

Në letrën e Trumpit, që mban datën 20 janar, thuhet se më 29 shtator të vitit 2025 ai njoftoi për Planin gjithëpërfshirës për t'i dhënë fund konfliktit në Gazë, përmes një plani 20-pikësh “që shpejt u mbështet nga të gjithë liderët botëror”. Aty përmendet edhe një rezolutë e Kombeve të Bashkuara që mbështet këtë plan. “Tani është koha që t'i bëjmë këto ëndrra realitet. Në zemër të planit është Bordi i Paqes, që është bordi më mbresëlënës i themeluar ndonjëherë”, thuhet në letrën e Trumpit.

Trump thotë se pret që të punojë me Osmanin për “shumë kohë në të ardhmen, drejt arritjes së qëllimit për paqe të qëndrueshme botërore, mirëqenie dhe madhështi për të gjithë”.

Disa media ndërkombëtare, duke u thirrur në burime, kanë raportuar se Trump dëshiron që shtetet të paguajnë 1 miliard dollarë për të qenë anëtarë të përhershëm. Sipas CNN-it, ata që



nuk e paguajnë këtë shumë do të kenë një mandat trevjeçar.

Këshilltari për media i Osmanit, Bekim Kupina i tha Radios Evropa e Lirë se një pagesë e tillë nuk është kërkuar. “Pra nuk është kërkuar pagesa prej 1 miliard dollarësh. E shihni edhe vet në ftesë”, tha ai.

Përveç Kosovës, edhe Shqipëria ka pranuar ftesën e Trumpit.

Ftesa të tilla kanë pranuar edhe udhëheqës të Izraelit, Turqisë, Emirateve të Bashkuara Arabe,

Egjyptit, Bahrejnit, Kanadasë, Argjentinës, Paraguajit, Azerbajxhanit dhe shteteve të tjera.

Trump ka ftuar po ashtu edhe Kinën dhe Rusinë. Por, jo të gjithë që kanë pranuar ftesën nga Trumpi janë zotuar për të qenë pjesë e Bordit. Ftesa për pjesëmarrje është refuzuar nga Franca dhe Suedia.

Ditë më parë u publikuan disa emra të tjerë që janë emëruar nga ShBA-ja për të qenë pjesë e këtij bordi.

Mes emrave përfshihen sekretari amerikan i Shtetit, Marco Rubio, i dërguari i posaçëm i presidentit Trump, Steve Witkoff, ish-kryeministri britanik, Tony Blair, dhe dhëndri i Trumpit, Jared Kushner.

Trump është kryetar i bordit, sipas një plani që Shtëpia e Bardhë e tij e bëri publik në tetor. Izraeli dhe grupi palestinez Hamas, e miratuan planin e Trumpit, që parashikon që një organ teknokratik palestinez të mbikëqyrë nga bordi ndërkombëtar, i cili do të mbikëqyrë qeverisjen e Gazës për një periudhë tranzitore.

Shumë ekspertë dhe aktivistë të të drejtave të njeriut kanë thënë se mbikëqyrja nga Trumpi e një bordi që kontrollon qeverisjen e një territori të huaj i ngjan një strukturë koloniale, ndërsa përfshirja e Blairit u kritikua vitin e kaluar për shkak të rolit të tij në luftën në Irak dhe historisë së imperializmit britanik në Lindjen e Mesme.

Një rezolutë e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, e miratuar në mes të nëntorit të vitit të kaluar, autorizoi bordin dhe vendet që punojnë me të për të krijuar këtë bord në Gazë.


Shtëpia e Bardhë po ashtu ka emëruar një Bord Ekzekutiv për Gazën, me 11 anëtarë, ku përfshihen ministri i Jashtëm i Turqisë, Hakan Fidan, koordinatorja e posaçme e OKB-së për procesin e paqes në Lindjen e Mesme, Sigrid Kaag, ministria e Emirateve të Bashkuara Arabe për Bashkëpunim Ndërkombëtar, Reem Al-Hashimy, dhe miliarderi izraelito-qipriot, Yakir Gabay, së bashku me disa anëtarë të bordit ekzekutiv.

Shtëpia e Bardhë ka konfirmuar se ish-ministri i Jashtëm bullgar, Nikolay Mladenov, do të udhëheqë administratën kalimtare në Gazë.

Ky bord shtesë do të mbështesë zyrën e Mladenovit dhe organin teknokratik palestinez.

Tre muaj më parë, Izraeli dhe Hamasi u pajtuan për armëpushim, por që atëherë palët kanë këmbyer akuza për shkelje të tij.

Lufta mes Izraelit dhe Hamasit nisi në tetor të vitit 2023, pasi Hamasi sulmoi jugun e Izraelit duke vrarë afër 1.200 persona dhe duke rrëmbyer më shumë se 250 të tjerë. Lufta ka vrarë dhjetëra mijëra njerëz në Gazë, ka shkaktuar një krizë urie dhe ka sjellë shkatërrime të mëdha.





ZGJEDHJET E 28 DHJETORIT 2025, ÇFARË NDODHI NGA VOTIMI DERI TE RINUMËRIMI I PLOTË?

PRISHTINË, 21 JANAR - Procesi zgjedhor i 28 dhjetorit 2025 është shoqëruar me zhvillime të shumta dhe vendime të rëndësishme institucionale, të cilat kanë nxjerrë në pah parregullsi serioze në administrimin dhe numërimin e votave në disa komuna të Kosovës. Menjëherë pas ditës së zgjedhjeve dhe publikimit të rezultateve preliminare, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka pranuar ankesa dhe raporte të shumta lidhur me parregullsi gjatë numërimit të votave, veçanërisht në nivelin e votave të kandidatëve brenda subjekteve politike.

Por, çfarë ndodhi?

Fillimisht, KQZ-ja ka marrë vendim që në 10 komuna të zhvillohet rinumërim i plotë i votave, me qëllim të verifikimit të saktësisë së rezultateve dhe adresimit të dyshimeve të ngritura. Ky vendim u mor pas identifikimit të mospërputhjeve

ndërmjet rezultateve të raportuara dhe materialeve zgjedhore. Megjithatë, gjatë këtij procesi janë evidentuar raste të dyshimit vjedhjes së votave dhe manipulime brenda subjekteve politike, ku votat dyshohet se janë transferuar nga një kandidat te tjetri. Si rezultat, KQZ-ja mori një vendim të ri dhe më gjithëpërfshirës, duke urdhëruar që të gjitha 28 komunat e vendit të shkojnë në rinumërim të plotë të votave, në mënyrë që të garantohet transparenca dhe besueshmëria e rezultateve përfundimtare. Po ashtu, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka vendosur që anëtarët e subjekteve politike në Komisionin Komunal të Zgjedhjeve (KKZ) në komunën e Prizrenit të shkarkohen nga detyra, për shkak të përgjegjësisë së dyshuar në parregullsitë e konstatuara. KQZ-ja ka paralajmëruar se do të bashkëpunojë ngushtë me organet e drejtësisë për hetimin e plotë të rasteve dhe ndëshkimin e përgjegjësve.

Çfarë thonë njohësit e fushës?

Në lidhje me këtë situatë, analisti politik Mazllum Baraliu vlerëson se ky proces ka nxjerrë në pah defekte serioze në sistemin zgjedhor. “Procesi paraprak kishte defekte në sistemin e llogaritjes dhe publikimit të rezultateve preliminare, gjë që shkaktoi befasi, pritje dhe pakënaqësi si në opinion, ashtu edhe në partitë politike. Procesi i rinumërimit po nxjerr në pah defekte serioze që janë lejuar të ndodhin, si rasti i Prizrenit, por edhe në komuna të tjera”, ka deklaruar Baraliu. Sipas tij, vendimi për rinumërim total po e zvarrit shpalljen dhe certifikimin e rezultateve përfundimtare, duke ndikuar drejtpërdrejt në respektimin e afateve kushtetuese. “Jemi në ngushticë kohore për konstituimin e Kuvendit, formimin e Qeverisë, zgjedhjen e presidentit dhe miratimin e buxhetit. Prandaj, KQZ duhet të angazhojë kapacitete shtesë, me punë në tri ndërrime, 24 orë, në

mënyrë që procesi të mos stërzgjatet”, ka theksuar ai shkruan Telegrafi. Ndërkohë, Eugen Cakolli nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), në një deklaratë për Telegrafin e ka cilësuar këtë proces zgjedhor si një proces me “dy fytyra”. “Së pari, kemi një imazh jashtëzakonisht pozitiv të organizimit dhe administrimit të votimit në ditën e zgjedhjeve, transparencës së KQZ-së dhe shpejtësisë në publikimin e rezultateve preliminare. Në anën tjetër, kemi një nga cenimet më të rënda të procesit zgjedhor pas vitit 2010, me skema manipulimi, në disa raste edhe industriale të votave të kandidatëve”, ka deklaruar Cakolli. Ai ka theksuar se qytetarët kanë treguar pjekuri të lartë demokratike, ndërsa integriteti i zgjedhjeve është cenuar nga komisionerë të caktuar. “Kjo situatë dëshmon nevojën e pashmangshme për rishikimin e sistemit të numërimit të votave. Kalimi i numërimit në qendrat komunale ka rritur potencialin për manipulime, pasi mjafton ndërhyrja e një zyrtari për të

deformuar tërësisht rezultatin”, ka thënë ai. Sipas Cakollit, zgjidhja afatgjate duhet të jetë kalimi në numërim digjital, i cili do ta zvogëlonte ndërhyrjen dhe do ta përshpejtonte ndjeshëm procesin. “Personat që kanë kryer shkelje, manipulime apo keqpërdorime duhet të hetohen dhe të dënohen sa më parë, në mënyrë që raste të tilla të mos përsëriten dhe dënimet të kenë efekt parandalues”, ka përfunduar Cakolli. Ndryshe, në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve është duke vazhduar numërimi i fletëvotimeve sipas listës së vendvotimeve për të cilat KQZ-ja ka marrë vendim që të rinumërohen. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve njofton se nga fillimi i këtij procesi (e martë, 13 janar 2026, ora 18:00) dhe deri më tani (e mërkurë, 21 janar 2026, ora 10:00) janë rinumëruar 834 nga 2,557 vendvotime. Sipas këtyre të dhënave, deri më tani rinumërimi është përmbyllur plotësisht në shtatë komuna.

MEDIAT SHQIPTARE: IVANKA TRUMP VIZITON SHQIPËRINË LIDHUR ME INVESTIMET NË SAZAN

TIRANË, 21 JANAR - Ivanka Trump, vajza e presidentit amerikan, Donald Trump, ka arritur në Shqipëri të mërkurën, në një vizitë të paparalajmëruar.

Siç kanë raportuar mediat në Shqipëri, përfshirë televizionin shtetëror, RTSH, Trump po qëndron në qytetin e Vlorës.

Vizita e saj, sipas raportimeve, ka të bëjë me investimin në Shqipëri të planifikuar nga kompania e bashkëshortit të saj, Jared Kushner, në ishullin Sazan të Shqipërisë.

Disa media kanë raportuar se pjesë e vizitës ka qenë edhe vetë Kushner, por ai është parë në të njëjtën kohë me ekipin e presidentit Trump në Forumin Ekonomik të Davosit në Zvicër.

Sipas raportimeve që ende nuk kanë ndonjë konfirmim zyrtar, Trump do të zhvillojë takim me një studio arkitekture, ndërsa deri më tani nuk është paralajmëruar për ndonjë takim me përfaqësuesit shtetërorë të Shqipëri.

Çifti po ashtu deri më tani nuk kanë publikuar asgjë në lidhje



me vizitën në rrjetet e tyre sociale.

Në fund të vitit 2024, kompania e Kushnerit ka fituar statusin e investitorit strategjik në Shqipëri për një resort turistik në ishullin e Sazanit në afërsi të Vlorës.

Në një deklaratë për Radion Evropa e Lirë, më 16 janar, Agjencia Shqiptare për

Zhvillimin e Investimeve ka thënë se “projekti ndodhet në fazën e procesit të negocimit të marrëveshjes ndërmjet shtetit shqiptar dhe subjektit privat investues”.

Sipas ligjit, dhënia e statusit të investitorit strategjik lejon kompaninë që të zbatojë projektin që vlerësohet strategjik

në një sektor të ekonomisë, siç është turizmi.

Po ashtu, ky status do të bëjë që projekti “të përfitojë nga procedurat e përshpejtuara dhe përfitime të tjera”.

Statusi i investitorit strategjik, kompanisë së Kushnerit i është dhënë për periudhën 10-vjeçare. Shqipëria, më herët ka thënë se

ka të drejtë të revokojë vendimin, në varësi të negociatave përfundimtare të projektit.

Më 2024, Kushner kishte publikuar në rrjetet sociale dizajnet potenciale të investimeve të firmës së tij në Shqipëri.

Sazani është një ishull kryesisht i braktisur dhe aktualisht është bazë ushtarake dhe gjysmë i hapur për publikun.

Kushner, në të kaluarën, ka deklaruar gjithashtu se dëshiron të ndërtojë disa hotele dhe qindra vila në Zvërnec, një zonë bregdetare në Vlorë, në jug të Shqipërisë.

Mirëpo deri më tani nuk ka informacione zyrtare se është bërë ndonjë aplikim për këtë investim.

Planet e Kushnerit ishin përballur me kundërshtime në Shqipëri, sidomos nga ambientalistët që kishin thënë se mund të shkaktohen dëme në zonat e mbrojtura bregdetare, sidomos për zonën e Zvërnecit.

KOSOVA DHE BAHAMET NËN SHKRUANJNË MARRËVESHJE PËR HEQJEN E NDËRSJELLË TË VIZAVE



PRISHTINË, 21 JANAR - Kosova dhe Bahamet kanë nënshkruar marrëveshje për heqjen e ndërsjellë të vizave për qytetarët e tyre, njoftoi Presidenca kosovare të martën. “Ky hap dëshmon përkushtimin e përbashkët për forcimin e partneritetit ndërmjet Kosovës e Bahamas dhe, mbi të gjitha, për forcimin e lidhjeve mes qytetarëve tanë, duke i afëruar ata edhe më shumë me njëritjetrin”, tha Presidenca në “Facebook”.

Heqja e vizave për qytetarët e tyre vjen një muaj pasi Bahamet e njohën pavarësinë e Kosovës. Presidenca tha se heqja e vizave ishte hapi i radhës për të cilin ishin pajtuar në dhjetor

presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, dhe kryeministri i Bahameve, Philip Davis, kur e nënshkruan marrëveshjen për lidhjen e marrëdhënieve mes dy vendeve.

Bahamet - vendi ishullor i Oqeanit Atlantik, u bënë vendi 121-të i botës që e njeh Kosovën. Ky vend në Karaibe deri tani ka qenë në mesin e 106 vendeve të botës ku kosovarët detyrohen të pajisen me vizë para se të udhëtojnë për ta vizituar.

Tani, Bahamet janë vendi i 53-të në botë ku kosovarë mund të udhëtojnë lirshëm.

Në vitet e fundit vendime të ngjashme për t'ia hequr regjimin e vizave kosovarëve kishin marrë edhe Tajvani e Malajzia.

Më 17 shkurt mbahet protestë në mbrojtje të çlirimtarëve që po mbahen në Hagë


Prishtinë, 21 janar- Me moton “Drejtësi, jo politikë”, do të protestohet më 17 shkurt në orën 14:00 në sheshin “Skënderbeu” në Prishtinë, që qëllim ka vetëm mbrojtjen e çlirimtarëve të cilët po mbahen në Hagë.

Protesta do të organizohet nga platforma “Liria ka Emër”, ku gjatë një konference për medie, Eliza Hoxha e Ismail

Tasholli kanë theksuar se data 17 shkurt nuk është zgjedhur rastësisht, por se ajo përkon me Ditën e Pavarësisë së Kosovës dhe me momentin historik të shpalljes së saj, duke e bërë këtë protestë një akt simbolik dhe qytetar në mbrojtje të parimit të drejtësisë.

Platforma “Liria ka Emër” ka vlerësuar se procesi gjyqësor

në Hagë, i cili ka hyrë në fazën përmbyllëse pas më shumë se pesë vjetësh, ka krijuar shqetësime serioze në opinionin publik. Zvarritja e procedurave, kompleksiteti i tyre, informacionet kontradiktore, si dhe perceptimi i ndikimit politik, kanë cenuar besimin qytetar se drejtësia po trajtohet si një proces thjesht juridik.



INSTITUCIONET E ZBATIMIT TË LIGJIT DHE SIGURISË NË KOSOVË FORCOJNË AFTËSITË PËRMES TRAJNIMIT TË UDHËHEQUR NGA DEA E SHBA-së

PRISHTINË, 21 JANAR - me mbështetjen e Departamentit të Drejtësisë së ShBA-së, Programit Ndërkombëtar për Asistencë në Trajnimin e Hetimeve Penale (DOJ-ICITAP), në partneritet dhe me trajnim të udhëhequr nga Administrata Amerikane për Zbatimin e Ligjit kundër Drogës (DEA), përfaqësues nga Policia e Kosovës, Agjencia e Forenzikës së Kosovës, Dogana e Kosovës dhe Forca e Sigurisë së Kosovës, përfunduan një program të fokusuar në zhvillimin dhe hartimin e kurrikulës. Kursi, i udhëhequr nga katër

ekspertë të fushës të DEA-s, forcoi aftësitë e pjesëmarrësve për të hartuar dhe për të realizuar trajnime efektive dhe bashkëkohore. Temat e trajtuara përfshijnë parimet e të mësuarit për të rritur, integrimin e informacioneve mbi trendët aktualë të drogave, zhvillimin e skenarëve të sigurt dhe në përputhje me politikën, teknikat e orientuara nga studenti, si dhe komunikimin efektiv përmes përdorimit të mjeteve trajnuese. Pjesëmarrësit i aplikuan këto aftësi përmes ushtrimeve praktike, gjatë të cilave hartuan

dhe prezantuan module instruktive, duke demonstruar përmirësime të menjëhershme në vetëbesim, zhvillim të kurrikulës dhe aftësi instruktive. Ky trajnim pasqyron bashkëpunimin e fuqishëm ndërmjet institucioneve të zbatimit të ligjit dhe sigurisë në Kosovë, ICITAP-it, DEA-s dhe partnerëve të Qeverisë së ShBA-së dhe mbështet përpjekjet e vazhdueshme të Kosovës për ndërtimin e institucioneve profesionale dhe të afta, të përkushtuara për një të ardhme më të sigurt dhe më të qëndrueshme.



KLINIKA E PEDIATRIKËS NË QKUK: MBI 44 MIJË VIZITA NË EMERGJENCË DHE SHFRYTËZIM MAKSIMAL I KAPACITETEVE



PRISHTINË, 21 JANAR - Gjatë vitit 2025, Klinika e Pediatrikë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK) ka shënuar një nivel të lartë të aktivitetit shëndetësor, duke ofruar shërbime të specializuara dhe kujdes të vazhdueshëm për pacientët pediatrikë nga i gjithë vendi. Klinika ka funksionuar me 151 shtretër, duke realizuar gjithsej 43,725 ditë mjekimi, me një shkallë mesatare të shfrytëzimit të kapaciteteve prej 79.17%. Gjatë kësaj periudhe janë regjistruar 44,698 vizita në Emergjencën e Pediatrikë dhe 20,765 vizita ambulantore

specialistike. Po ashtu, janë evidentuar 7,937 pranime dhe 7,948 lëshime të pacientëve. Fluksi më i madh i pacientëve është shënuar gjatë muajit dhjetor, kur janë realizuar 4,775 ditë mjekimi dhe shfrytëzimi i kapaciteteve ka arritur në 101.3%. V etëm gjatë këtij muaji janë regjistruar 4,619 vizita në Emergjencën Pediatrike, 740 pranime dhe 819 lëshime, duke reflektuar një ngarkesë të theksuar të shërbimeve shëndetësore. Duke marrë parasysh faktin se qyteti i Prishtinës nuk ka spital

dytësor, Klinika e Pediatrikë në QKUK-së ofron shërbime tretësore për të gjithë territorin e Kosovës, si dhe shërbime shëndetësore dytësore për Prishtinën dhe rrethinën. Gjatë vitit 2025, Klinika Pediatrike ka ofruar shërbime të specializuara në kujdesin intensiv pediatrik, hemato-onkologji, kardiologji, pulmologji, endokrinologji, gastroenterologji, neurologji, reumatologji, gjenetikë, nefrologji, si dhe në emergjencën pediatrike e cila përbën një nga pikat kryesore të trajtimit urgjent për pacientët pediatrik.

NË 27-VJETORIN E RËNIES, KRYETARI LATIFI PËRKUJTON DËSHMORËT SKËNDER REXHEPI DHE FITIM DURAKU

PRISHTINË, 21 JANAR - Në 27-vjetorin e rënies, kryetari i Rahovecit, Smajl Latifi, ka përkujtuar dëshmorët Skënder Rexhepin dhe Fitim Durakun, që u flijuan në luftën për çlirimin e tij. Latifi së bashku me bashkëpunëtorë, me familjarë të dëshmorëve, me bashkëluftëtarë, me drejtues të OVL të UÇK-së dhe me qytetarë, nderuan veprën dhe

jetën e tyre. “Skënder Rexhepi, i njohur si Komandant “Hekuri” dhe Fitim Duraku (Fita), i njohur për përkushtimin e tij në luftën e armatosur të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, bashkë me Xhavit Elshanin - Leopardin dhe Mustafë Bajraktarin, derisa ishin në krye të detyrës, më 21 janar 1999, u përballën me pritën e forcave serbe, gjë që çoi në rënien e Skënderit dhe në plagosjen e

Fitimit, i cili nga plagët e marra, vdiq më 4 prill, si dhe plagosjen e Xhavit Elshanit dhe të Mustafë Bajraktarit, të dy të ndjerë, të cilët jetuan për ta parë Kosovën të lirë. Ata, me angazhimin e tyre të madh për liri, lanë pas një trashëgimi të madhe atdhetarizmi. Përkujtojmë dhe nderojmë me respekt këta dy heronj, veprimtarë të hershëm të çështjes kombëtare, të

rreshtuar në organizata atdhetare që vepronin fshehtë kundër pushtuesit, LPK dhe LKÇK, më pas edhe luftëtarë të paepur të UÇK-së, që s'u ndalën deri në frymën e fundit së luftuari për liri dhe bashkim, si dhe të gjithë ata që dhanë jetën për lirinë dhe dinjitetin e kombit tonë! Qoftë i përjetshëm kujtimi për Skënder Rexhepin dhe Fitim Durakun!”, ka shkruar Latifi në “Facebook”.



Në Konsullatën e Kosovës në Nju-Jork nderohen viktimat e gjenocidit në Kosovë, kërkohet ndëshkimi ndërkombëtar i Serbisë

PRISHTINË, 21 JANAR - Në Konsullatën e Përgjithshme të Republikës së Kosovës në Nju-Jork, së bashku me përfaqësuesit e shoqatave shqiptare, janë nderuar viktimat e gjenocidit të kryer nga Serbia në Kosovë dhe kërkuar ndëshkimin

ndërkombëtar të kryesve të këtij krimi ndërkombëtar, të sanksionuar me Konventën e OKB-së. Ambasadori Blërim Reka dhe Mark Gjonaj, në emër të shoqatave shqiptare të Nju-Jorkut, rikujtuan edhe një herë se Serbia vrau 13,950 shqiptarë,

përdhunoi mbi 20,000 qytetare dhe qytetarë të Kosovës dhe se ende nuk janë gjetur 1,620 persona të zhdukur me forcë. “Ne nuk harrojmë! We will not forget!”, ka shkruar në “Facebook” Konsullata e Përgjithshme e Republikës së Kosovës në Nju-Jork.



IKD-ja: VEPRIMET E AGRON QALAJT PO BLOKOJNË ZBATIMIN E REFORMËS NË KPK

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 21 JANAR - Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) ka shprehur shqetësim të thellë lidhur me veprimet e Ushtruesit të Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, Agron Qalaj, të cilat po pengojnë drejtpërdrejt zbatimin e reformës në Këshillin Prokurorial të Kosovës (KPK). “Më 1 janar 2026 ishte paraparë që të fillojë reforma e shumëpritur në sistemin prokurorial të Kosovës. Me hyrjen në fuqi të Ligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për KPK, Këshilli Prokurorial i Kosovës nga fillimi i këtij viti do të ketë përbërje prej shtatë anëtarësh, nga 13 sa i kishte me legjislacionin e vjetër. Gjatë vitit të kaluar, prokurorët e prokurorive themelore, në një proces të bazuar në meritokraci, zgjodhën znj. Elsa Bajramin si përfaqësuese të tyre në Këshillin Prokurorial të Kosovës, mandati i së cilës do të duhej të fillonte më 1 janar të këtij viti. Përderisa pritjet legjitime të publikut janë se KPK do të ndërmarrë veprime konkrete në jetëzimin e reformës në sistemin prokurorial të Kosovës dhe në ruajtjen e

parimeve të sundimit të ligjit dhe integritetit të sistemit prokurorial, fatkeqësisht realiteti po dëshmon të kundërtën”, ka vlerësuar IKD-ja.

Sipas IKD-së, u.d. i Kryeprokurorit të Shtetit po vazhdon me mendësinë e vjetër të qeverisjes me Këshillin Prokurorial të Kosovës, duke shfrytëzuar interpretime të pabazuara ligjore të Zyrës Ligjore të Sekretariatit të KPK-së për të prolonguar funksionalizimin e Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe po synon ruajtjen e një mendësie korporatiste brenda sistemit prokurorial.

Për më tepër, IKD-ja vlerëson se konstatimi i Agron Qalaj se propozimi i një (1) anëtarit të KPK-së nuk ka marrë votat e nevojshme për miratim është në kundërshtim me Ligjin nr. 08/L-249 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për KPK. “Fillimisht, duhet theksuar se neni 37/A, i cili thekson se: ‘1. Deri në zbatimin e përbërjes së përhershme të Këshillit prej shtatë (7) anëtarësh, kuorumi i Këshillit formohet me gjysmën e anëtarëve të zgjedhur të Këshillit plus një (1) anëtar, duke përfshirë edhe rastet disiplinore, dhe vendimet merren me shumicë të



thjeshtë votash të anëtarëve të pranishëm’, është dispozitë kalimtare, e cila ka vlejtur në kohën kur KPK kishte mbi shtatë (7) anëtarë dhe zbritja e numrit të anëtarëve duhej të vinte gradualisht, siç tanimë ka ndodhur. Tanimë, në situatën kur kjo dispozitë kalimtare ka humbur fuqinë ligjore, aplikohet neni 13 i Ligjit në fjalë, i cili thekson se: ‘1. Kuorumi i Këshillit formohet me pesë (5) anëtarë, duke përfshirë edhe rastet disiplinore, përveç nëse parashihet ndryshe me këtë ligj; 2. Vendimet e Këshillit merren me shumicë të thjeshtë votash të të gjithë anëtarëve të Këshillit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj’. Sipas kësaj dispozite, situata është plotësisht e qartë: KPK ka kuorum të mjaftueshëm

prej pesë (5) anëtarësh për mbajtjen e takimit. Ndërkaq, vendimmarrja merret me shumicën e thjeshtë të votave të të gjithë anëtarëve të Këshillit. Ligji nuk i referohet tërësisë së numrit të anëtarëve, por i referohet “anëtarëve të Këshillit”, të cilët aktualisht janë pesë (5), dhe shumica e thjeshtë e tyre është tre (3)”, thekson IKD-ja. Në rastin konkret, propozimi i anëtarit të KPK-së ka përmbytur këtë kriter ligjor, pasi në mbledhje kanë qenë të pranishëm pesë (5) anëtarë të KPK-së, nga të cilët tre (3) kanë votuar pro dhe dy (2) kundër. Rrjedhimisht, propozimi ka marrë votat për miratim dhe do të duhej të konsiderohej i miratuar.

IKD-ja vlerëson se ndërhyrje të

tilla në procedurën e vendimmarrjes përbëjnë tentativë për të sabotuar reformën në KPK përmes shkeljeve të hapura ligjore. “Instituti i Kosovës për Drejtësi konsideron se përgjegjësia për këtë situatë i takon drejtpërdrejt ushtruesit të detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, i cili, në vend se të sigurojë zbatimin e ligjit dhe funksionimin ligjor të KPK-së, ka zgjedhur të bllokojë një proces të rregullt dhe të ligjshëm vendimmarrës. IKD i bën thirrje ushtruesit të detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, Agron Qalaj, që të veprojë në përputhje me detyrimet ligjore, duke e konstatuar pa vonesa certifikimin e rezultatit zgjedhor të 1 nëntorit 2025, ashtu siç u votua në takimin e djeshëm. U.D. i Kryeprokurorit të Shtetit do të duhej të shërbente si shembull i respektimit të ligjit dhe procedurës për të promovuar integritetin dhe kredibilitetin e sistemit prokurorial në këtë fazë kalimtare, duke marrë masa për funksionalizimin e Këshillit Prokurorial dhe për tranzicionin e shpejtë dhe pa vonesa te Kryesuesi i ardhshëm i KPK-së”, ka theksuar IKD-ja në reagimin për medie.

KURTI TAKON KOMISIONEREN E BE-së PËR ZGJERIM: PROGRESI DEMOKRATIK I KOSOVËS MERITON TË VLERËSOHET ME STATUSIN E VENDIT KANDIDAT



PRISHTINË, 21 JANAR - Kryeministri në detyrë, Albin Kurti në margjina të Forumit Ekonomik Botëror takoi Komisioneren e Bashkimit Evropian për Zgjerim, Marta Kos.

Në njoftimin e Kryeministrit bëhet me dije se në këtë takim u diskutua mbi progresin ekonomik dhe avancimin demokratik të vendit të cilat janë kyçe në rrugën tonë drejt Bashkimit Evropian.

Sipas njoftimit, kryeministri Kurti ka thënë se asnjë vend i Ballkanit Perëndimor nuk ka qenë më i përgatitur në momentin e

marrjes së statusit të vendit kandidat, andaj edhe progresi demokratik i Kosovës meriton të vlerësohet me këtë status. “Në takim u diskutua edhe rreth situatës gjeopolitike, Planit të Rritjes, bashkëpunimit rajonal dhe aktualitetit. Sa i përket bashkëpunimit rajonal, kryeministri Kurti theksoi se Kosova luan rol aktiv dhe konstruktiv dhe mbështet integrimin më të gjerë ekonomik të rajonit bazuar në vlerat dhe standardet e Bashkimit Evropian”, thuhet tutje në njoftimin e Kryeministrit.

Në 20-vjetorin e vdekjes përkujtohet ish-presidenti Rugova

PRISHTINË, 21 JANAR - Në 20-vjetorin e vdekjes së presidentit të parë të Kosovës, Ibrahim Rugova, udhëheqës shtetërorë, përfaqësues të misionëve diplomatike dhe krerë të subjekteve politike në vend kanë përkujtuar atë si ‘atin themeltar’ dhe ‘vizionarin e paqes’ në nderim të trashëgimisë së tij politike dhe

rolit të tij unik në ndërtimin e shtetit të Kosovës.

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka thënë se ish-presidenti Rugova ishte i butë në sjellje, por i palëkundur në qëndrime.

Ajo kujtoi se ai a kushtoi gjithë jetën ndërtimit dhe mbrojtjes së shtetit të lirë, të pavarur dhe demokratik të Kosovës. “Në

betejën për liri, për dinjitet dhe shtet, Rugova e zgjodhi paqen, jo si dobësi, por si formë më të lartë të guximit politik. Për Rugovën, liria e mendimit ishte themeli mbi të cilën ndërtohej liria fizike. Kjo ishte pikënisja e një mendimi politik që do ta udhëhiqte Kosovën drejtë lirisë”, theksoi të mërkurën presidentja Osmani.



Shpërndahen pasqyrat vjetore të pensioneve

PRISHTINË, 21 JANAR - Fondi i Kursimeve Pensionale i Kosovës (FKPK) ka njoftuar se ka filluar shpërndarja e pasqyrave vjetore për vitin 2025 për të gjithë kontribuuesit. Sipas njoftimit, pasqyrat po dërgohen fillimisht përmes

emailit për ata kontribuues që FKPK ka adresa elektronike, ndërsa në ditët në vijim do të nisë edhe shpërndarja me postë. “Për këtë vit, numri i pasqyrave që po shpërndahen me email është 455,692, ndërsa me postë do të dërgohen 167,177 pasqyra vjetore”,

thuhet në njoftimin e FKPK-së. Fondi rikujton se mënyra më e mirë për të monitoruar kursimet pensionale në baza ditore është regjistrimi në portalin eTrusti, i cili mund të aksesohen në: online.trusti.org. Gjithashtu, pasqyra e llogarisë

mund të shkarkohet edhe përmes platformës eKosova, në seksionin “Kontributet dhe pensioni”. Ky proces synon të sigurojë që çdo kontribues të ketë informacion të qartë dhe të përditësuar mbi kursimet e tij pensionale për vitin 2025.



KURTI NË DAVOS PREZANTOI PRIORITETIN E INVESTIMEVE PUBLIKE ME MBI 7 MILIARDË EURO NË TRANSPORT

DAVOS, 21 JANAR - Kryeministri në detyrë i Kosovës, Albin Kurti, ka zhvilluar drekë pune në Shtëpinë e Kosovës me përfaqësues nga Këshilli i Jashtëm për Marrëdhënie Ekonomike, mes tyre Alexander Kunitz dhe Maximilian Hoffmann, si dhe drejtorin ekzekutiv Max Gulde nga “Constellr”, Carl Holshouser nga “CoreWeave”, Dr. Tanja Wielgoß nga “SPD Economic Council” dhe Matthias Ibrahim Krug nga “Velmore Capital”. Ata diskutuan mbi integritetin konkurrues si bazë për besim, qëndrueshmëri institucionale dhe klimë më tërheqëse për

investime. Kryeministri Kurti theksoi progresin e Kosovës në siguri, sundim të ligjit dhe stabilitet makro-fiskal si faktorë që përkthehen drejtpërdrejt në mjedis më të mirë biznesi. U diskutua pozicionimi i Kosovës si nyje për kompanitë që kërkojnë kapacitete të besueshme dhe afër tregjeve të EMENA-s. Kryeministri prezantoi prioritetin e investimeve publike me mbi 7 miliardë euro në transport, mjedis dhe energji për të përmirësuar logjistikën dhe parashikueshmërinë ekonomike.



TRIM TËRNAVA EMËROHET KRYESHEF I RI I KOSTT-it



PRISHTINË, 21 JANAR - Trim Tërnavë do të jetë kryeshef i ri i Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës (KOSTT). Ai është zgjedhur pas përfundimit të të gjitha procedurave të konkursit. “Pas zhvillimit të një procesi transparent dhe konkurrues, në përputhje me Ligjin për Ndërmarrjet Publike, Bordi i Drejtorëve i KOSTT Sh.A., në mbledhjen e mbajtur më 19 janar 2026, njëzëri ka emëruar z. Trim Tërnavën kryeshef ekzekutiv të KOSTT Sh.A. i cili do të fillojë këtë detyrë nga data 16 shkurt 2026. Trim Tërnavë ka përfunduar studimet master në Ekonomi të Energjisë në Rice University, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ndërsa

studimet themelore i ka përfunduar në Inxhinieri Elektrike në Universitetin e Prishtinës. Trim Tërnavë ka përgatitur të avancuar akademike dhe profesionale në sektorin e energjisë, me fokus në ekonominë e energjisë, zhvillimin e tregut të energjisë, tranzicionin energjetik dhe proceset e integritetit rajonal dhe evropian. Ai ka një dekadë përvojë profesionale dhe udhëheqëse në sektorin e energjisë dhe synon forcimin e rolit të KOSTT në arritjen dhe avancimin e objektivave strategjike të shoqërisë, duke theksuar operimin e sigurt, të qëndrueshëm dhe të besueshëm të Sistemit të Transmetimit dhe Tregut të energjisë elektrike”, ka njoftuar KOSTT.

Ari arrin nivel rekord

UASHINGTON, 21 JANAR - Ari u rrit në nivel rekord, ndërsa bursat ranë teksa Trumpi udhëtoi për në Davos. Çmimi i arit u rrit në një nivel historik të mërkurën, duke u nxitur nga kërkesa për asete të sigurta, ndërsa presidenti

amerikan Donald Trump udhëton për në Davos për Forumin Ekonomik Botëror. Metali i çmuar u rrit me më shumë se 2 për qind, ndërsa çmimi i argjendit u rrit rreth 0.44 për qind. Bursat kryesore evropiane

ranë pas dy ditësh fitimesh, raporton euronews. Indeksi francez CAC 40 ra me 0.18 për qind, DAX-i gjerman me 0.68 për qind, ndërsa IBEX 35 i Spanjës humbi 0.53 për qind. Indeksi italian FTSE MIB ra me 0.68 për qind, ndërsa

STOXX Europe 500 zbriti me 0.35 për qind. Para hapjes së tregjeve në ShBA, kontratat e ardhshme për indeksin S&P 500 u rritën me 0.34 për qind, ato të Dow Jones me 0.13 për qind, ndërsa Nasdaq me 0.19 për qind.



KALBJA E TRURIT NGA TV-ja: ARSYEJA E VËRTETË PSE SERIALET TELEVIZIVE PO BËHEN PA MEND



Nga: Louis CHILTON / *The Independent*

A po bëhet televizori më i marrë? Në industrinë e sotme të zbavitjes, rënia e vëmendjes dhe shikuesit e painteresuar po trajtohen jo si pengesa për t'u kapërcyer, por si mundësi tregu. Javën e kaluar, Ben Affleck dhe Matt Damon, duke promovuar filmin e tyre të ri në Netflix, The Rip, duket se konfirmuan atë që është përfolur prej kohësh për prodhimet e Netflix-it - se krijuesve u thuhet qartë që të përshtaten me të ashtuquajturit “shikues në dy ekrane” - ata të cilët e trajtojnë televizorin si diçka që mund të shihet me gjysmë vëmendjeje, ndërsa janë të zënë me Instagram-in, TikTok-in apo ndonjë blog të drejtpërdrejtë mbi sagën e Brooklyn Beckhamit. Damoni bëri shaka duke thënë se Netflix-i i kishte thënë: “Nuk do të ishte keq po të përsërisnit temën tri ose katër herë në dialog, sepse njerëzit janë në telefon teksa shikojnë”. Ai shtoi: “Kjo me të vërtetë do të fillojë të shkel mbi mënyrën se si tregohen ngjarjet”. E, pra, saktësisht kështu. Nuk është ndonjë zbulim i madh: edhe po të mos kishit lexuar viteve të fundit shumë raportime për kufizimet kreative që u imponohen sot producentëve, kjo zakonisht është e dukshme duke parë produktin përfundimtar. Këtë e ndjen edhe në serialet më të mëdha të platformës, si Wednesday dhe Stranger Things, apo në adaptimin e fundit të Harlan Cobenit, Run Away. Do të ishte budallallëk të mohojë që çdo përsëritje në dialog apo çdo ekspozim i ngathët të ishte pjesë

e një strategjie të qëllimshme - por, nëse sheh mjaftueshëm nga këto përmbajtje në internet, disa modele bëhen të dukshme. Dhe, zakonisht, është më keq në TV sesa në film, sepse regjisorët e mëdhenj të filmave shpesh kanë më shumë kontroll. Problemi, sigurisht, qëndron tek ata që nuk janë duke plotësuar fjalëkryqin e New York Times-it ndërkohë që shikojnë TV, por që shpresojnë të ulen e të përfshihen në një program, qoftë për vlerën artistike apo si një mënyrë për t'u shkëputur nga realiteti. Për këta shikues, përsëritjet e panevojshme e bëjnë përvojën të mërzitshme dhe fyese. Në një farë kuptimi, natyrisht, nuk ka asgjë të re keqdashëse rreth këtij trendi të ri. Dikur në ditët para të transmetimit në internet, para përhapjes së seteve të DVD-së, televizioni gjithashtu duhej t'i përshtatej një lloji të caktuar të shikuesit pasiv. Duhej, pjesërisht, të merrte parasysh ata që ishin kyçur me vonesë, duke humbur kështu pjesën e parë të një programi - dhe ndërprerjet për reklama shpesh kërkonin që personazhet të përmbliidhnin ngjarjen me një kuptim të ngathët të drejtpërdrejt. Serialët më të mira të vjetra televizive nuk e shmangnin këtë, por thjesht gjenin mënyra elegante, artistike, apo edhe qesharake për të përfshirë këto dromca. Kujto, për shembull, një episod të Simpsons që kthehet nga një ndërprerje me reklama, me Homerin që detajon saktësisht se ku janë tani personazhet dhe pse, ndërsa Barti komenton: “Çfarë gjëje e çuditshme për të thënë”. Megjithatë, rënia e ngadaltë e televizionit në marrëzi shkon përtej kësaj çështjeje të vetme. Si një formë arti, duket se TV-ja po

bën regres në shumë fronte. Pashë dje një diskutim në rrjetet sociale rreth ndikimit të qëndrueshëm të The Wire - dramës gjithëpërfshirëse kriminale, të sofistikuar dhe jashtëzakonisht mbresëlënëse të David Simonit, që ende renditet ndër veprat më të mira në ekranin e shekullit XXI. Keqkuptimi ishte se seria, pavarësisht lavdërimit të përgjithshëm dhe fanatik që i është dhënë, në fakt mbaroi duke pasur pak ndikim te TV-ja që pasoi - nëse The Wire përdori kanavacën e pakufishme TV-së për të shtyrë narracionin e ekranit përtej kufijve ekzistues, atëherë asnjë shfaqje, që atëherë, nuk ka synuar me të vërtetë të bëjë të njëjtën gjë. Dhe, është e vështirë të argumentohet se kjo nuk është kështu. Është gjithashtu e vërtetë që shfaqjet e tjera nga “epoka e artë” e TV-së - The Sopranos, Deadwood ose edhe Mad Men - bënëin gjërat të cilat asnjë gjë tani në TV nuk i provon me sukses. Kishte një kompleksitet të jashtëzakonshëm në një episod të The Sopranos, të mënyra se si historitë pasqyroheshin dhe thelloheshin njëra në tjetrën brenda një ore, gjë që ndihej vërtet si letërsi. Nëse shohim programet më të mira televizive të viteve të fundit - marrim, për shembull, Succession, një veper jashtëzakonisht e zgjuar televizive, qesharake, me aktrim të mirë dhe mjeshtëror - edhe kjo nuk ka të njëjtën zgjuarsiri të narracionit. Në thelb, historia e saj është e drejtpërdrejt, kuptimet e saj të dukshme. Si të gjitha shfaqjet e suksesshme tani, Succession gjithashtu gjithmonë mbajti një sy te rrjetet sociale. Jo patjetër te “shikuesi imagjinar me

ekran të dytë”, por te tekat e vivisekcionistëve ose zetjeistëve të internetit. Shfaqjet televizive tani duhet të jenë së pari dhe mbi të gjitha të përshtatshme për meme. Shiva (Sarah Snook) është mbresëlënëse, e matur dhe jashtëzakonisht e besueshme, por a nuk i rrinte mirë ai kostum me pantallona? Dinamika e ndërlikuar midis Tomit dhe Gregut thotë njëqind gjëra të ndryshme rreth mekanizmave të pushtetit dhe klasës, por çfarë nëse do të ishte kondensuar në një montazh homoerotik? Sigurisht, thesaret e “epokës së artë” të TV-së, ishin të tilla për një arsye; ato ishin më të zgjuara dhe më komplekse se pothuajse gjithçka që kishte ardhur më parë. Por, edhe në të kaluarën e largët, kur TV-ja ende konsiderohej si “Kutia e idiotëve”, është fakt se shumë shfaqje televizive, në shumë mënyra ishin më të zgjuara sesa ato që kemi tani. Nëse shikon një episod të Cheers - një sitkom jashtëzakonisht popullor dhe i lehtë - mund të dëgjosh referenca për regjisorë të huaj filmi, për muzikantë klasikë, për romancierë rusë. Niveli i njohurive të supozuara atëherë ishte shumë më i madh; tani TV-ja rrallë është aventuresk në aludimet e veta. Në një farë mase, ky nuk është faji i TV-së, por më shumë reflektim i botës ku jetojmë: përderisa monokultura jonë e përbashkët është copëtuar dhe shpërndarë, thjesht nuk ekziston e njëjta bankë referencash për t'u përdorur. (Temat e njohura të diskutueshme që ekzistojnë, pothuajse gjithmonë i përkasin fushave më të reja, më aktuale të kulturës: muzika pop; kinemaja.) Por, është vetëm gjysma e

justifikimit - jo të gjithë që shikojnë Cheers pritej të dinin se kush ishte Gustav Mahleri apo Ingmar Bergmani; megjithatë, shakatë bëheshin gjithsesi. Tani, TV-ja është tepër e etur për të pasur prioritet qasjen. Krijuesit janë të përcaktuar që shikuesit të mos mbeten pas - qoftë sepse ata kanë një sy te telefonat e tyre, apo sepse nuk dinë se kush është Carl Jungu. Ajo që ka mbetur është një formë arti që heziton të shikojë jashtë, një formë arti që po bëhet gjithnjë e më i mbyllur. Në intervistën e tyre në podkastin e Joe Roganit, Afflecku dhe Damoni përmendën një serial tjetër të Netflix-it, Adolescence, si një “përjashtim” nga rregulli - provë se TV-ja që ka vlerë ende po punon pa u komprometuar nga kërkesat sistematike. Edhe gjatë vitit të kaluar, ka pasur një numër serialesh që ishin inteligjente dhe origjinale, programe të dizajnuara për t'u parë si duhet dhe me vëmendje. Është për ngushëllim që serialet e tilla si Adolescence, apo Pluribus, apo The Chair Company, mund të gjejnë audienca të konsiderueshme pa u dorëzuar ndaj instinkteve më të ulëta të mentalitetit të epokës së transmetimeve në internet. Ndoshta ato janë përjashtime, por janë diçka, të paktën. Në fund të fundit, nuk ka ndonjë përfitim afatgjatë në krijimin e TV-së që i pëlqen të painteresuarve. Televizioni, me fjalë të tjera, nuk ka nevojë të jetë budalla - le të shpresojmë se ata që janë në krye janë mjaftueshëm të zgjuar për ta kuptuar këtë. /Telegrafi/

LETËR ATDHETARIT E PATRIOTIT TË MADH KOMBËTAR HASAN MALAJ



Ismet SYLEJMANI

I dashur dhe shumë i nderuar atdhetari e patrioti i madh kombëtar Hasan Malaj!

I dashur dhe shumë i nderuar atdhetari e patrioti i madh kombëtar Hasan Malaj, djali i madh i plakut legjendë, Axhës Mehmet Malaj!

I dashur dhe shumë i nderuar atdhetari e patrioti i madh kombëtar Hasan Malaj, vëllau i Heroit të Kombit Rexhep Malaj!

I dashur dhe shumë i nderuar atdhetari e patrioti i madh kombëtar Hasan Malaj, simboli i vazhdimit të rrugës së luftës për liri të Vëllaut Tënd, gjatë kohës sa vuante neper kazamatet e ish-Jugosllavisë, por edhe pas vrasjes së Tij nga forcat ushtarko policore pushtuese serbe dhe tradhtarë, Heroit të Kombit Rexhep Malaj!

Shumë i dashur dhe i nderuar Hasan Malaj,

Unë që po të shkruaj letër, jam Ismet Sylejmani nga Cernica e Gjilanit, jam njëri nga ata djemt, të asaj gjenerate të madhe, që ishim te vendosur të ecnim me çdo kusht rrugës së Heronjëve e Dëshmorëve të Kombit, por edhe rrugës Tuaj, rrugës heroike të juve vazhduesve të drejtpërdrejtë të udhëheqësve tanë, veprimtarëve e drejtuesve të mëdhenj të çështjes kombëtare!

I dashur dhe shumë i nderuar Hasan Malaj,

Ti u bërë krah i fortë dhe i pathyeshëm i udhëheqjes së Lëvizjes politike atdhetare e patriotike për çlirim të Kosovës në mërgim, që udhëhiqej me aq përkushtim e vendosmeri nga Udhëheqësi i madh e i lavdishëm, Heroi i Kombit Kadri Zeka me shokë e bashkëveprimtar!

Edhe pas vrasjes së Heroit të Kombit Kadri Zeka, Ti i dashur dhe i nderuar Hasan Malaj, nuk e ndale veprimtarinë politike - atdhetare e patriotike në shërbim të luftës për liri e çlirim të Kosovës nga Serbia pushtuese! Ishte goditje e rëndë në përgjithësi e për Ty në veçanti vrasja e Heronjëve të Kombit Kadri Zeka, Jusuf e Bardhosh Gervalla, sepse Ti kishe barrë të madhe mbi supe, Vëllaun e kishe në burg por edhe familjen të burgosur e të izoluar në Kosovën e robëruar!

I dashur dhe shume i nderuar Hasan Malaj,

Dalja nga burgu i Vëllaut Tend Rexhep Malaj dhe vazhdimi i menjihershëm i veprimtarisë së Tij për liri e çlirim të Kosovës, sigurisht se nuk të ka zenë të papaërgaditur, sepse duke e njohur nga afer Babin Tënd, të

paperkulurin Axhen Mehmet Malaj, por edhe duke mësuar me pishë e me ngulm për të njohur në thelb e në esencë, çdo hap e çdo hallkë të vogël e të madhe të veprimtarisë së idolit tonë Rexhep Malaj e marrim me mend dhe besonim fortë se Ti Hasan Malaj, je i pathyeshëm dhe se je vazhdues i madh e besnik e i palekundur i rrugës së vëllaut Tënd çelik e të panënshtuar, të papërseritshmit të papërballuar, e te papërkulur Heroit të Kombit Rexhep Malaj!

I dashur dhe shume i nderuar Hasan Malaj,

Edhe me parë por veçanërisht pas vrasjes së Komandantit tonë, Heroit të Kombit Rexhep Malaj, Ty dhe familjen Tënde të madhe e lridashëse, e mbërtheu në darë të hekurt dhuna dhe terrori i aparatit shtetror serb e tradhtar në Kosovën e okupuar!

Si asnjë tjetër në historinë e luftimeve për liri e çlirim, Ti i dashur dhe i nderuarHasna Malaj, e kishe Vëllaun të vrarë dhe krejt familjen në burg e biseda informative, bashkëshorten, djemt e vajzat! Brenda në shtëpinë Tënde Kala të papushtuar qëndronte shqipatri lis, burri i madh, plaku i legjendave, i lavdishmi, zemërmadhi i pathyeshëm Axha Mehmet Malaj!

I dashur dhe shumë i nderuar Hasan Malaj,


Ushtria Çlirimtare e Kosovës, në ballë me simbolin e saj, Komandantin Legjendar Adem Jasharin dhe me Shtatë Zonat Operative, me Brigadat, Batalionet, Togjet, Skuadrat dhe njësi e grupe te tjera të organizmit ushtarak të panumerta luftarake heroike, me mijëra Heronjë e Dëshmorë që e derdhen gjakun rrëke dhe me ushtarët trima e të përkrahur nga aleati ynë çlirimtar Shtetet e Bashkuara te Amerikes, ia ka nxjerrë hakun katërcipërisht Vëllaut Tënd e Udhëheqësit tonë të madh e të lavdishëm Rexhep Malaj, e shokut të Tij të pandashëm Heroit të Kombit Nuhi Berisha dhe e ka bërë realitet çlirimin e Kosovës nga Serbia pushtuese!

I dashur dhe shumë i nderuar Hasan Malaj,

Pas çlirimit të Kosovës dhe pas largimit Serbisë pushtuese, Komanda e Shtabit të Zonës Operative të Karadakut të UÇK-së u vendos në shtëpinë Tënde, në shenjë nderimi për Vëllaun Tënd, për Komandantin tonë, Heroin e Kombit Rexhep Malaj!

Nuk ka një rast tjetër në Zonat Operative të UÇK-së, që Komanda e Shtabit të jetë vendosur në një shtëpi pas çlirimit, sikur rasti me shtëpinë Tënde shumë i dashur e i nderuar Hasan Malaj!

Zona Operative e Karadakut të UÇK-së ishte me fat që e kishte në zonën e saj një Kullë heroike, sikur Kulla Jote i dashur e i nderuar Hasan Malaj, e ta vendoste Selinë e Shabit të Saj në Gjilanin e çliruar



HASAN MALAJ

nga Serbia pushtuese!

Pas 12 Qershorit të vitit 1999, pas largimit të Serbisë pushtuese nga Kosova, Ti i dashur dhe i nderuar Hasan Malaj, je nderuar e je respektuar me një varg të pafund nderimesh në evenimente të ndryshme, të cilat pa as më të voglin dyshim na kanë gëzuar shumë!

I dashur dhe shume i nderuar Hasan Malaj,

Je shpallur Qytetar Nderi i Gjilanit, të është përgaditur film dokumentar e janë shkruar shumë shkrime dhe të janë kushtuar krijime të ndryshme, nderime të cilat janë të pakta karshi kontributit Tënd të madh dhe luftës për liri e çlirim të Kosovës!

I dashur dhe shumë i nderuar Hasan Malaj,

Shtëpia Jotë e ka Lapidarin e UÇK-se, dëshminë historike se Shtabi i UÇK-se, ishte i vendosur aty! Shtëpia Jote është shpallur Shtëpi Muze dhe Shteti i Kosovës e ka marrë në mbrojtje!

Shtëpinë Tënde e ka vizituar Presidenti i Shqipërisë Bajram Begaj!

Gjilani dhe Kosova e viset e saj nën ish - Jugosllavi, por edhe e gjithë shqiptaria anë e kend ushqejnë një simpati e admirim të paimagjinueshëm për Vëllaun Tënd Heroin e Kombit Rexhep

Malaj, për Babain Tënd plakun hero dhe për Ty e për të gjithë familjen Tënde lridashëse e me kontribute të mëdha për liri e çlirim nga Serbia pushtuese!

I dashur dhe shumë i nderuar Hasan Malaj,

E dime se Ti je i lindur ne vitin 1940 dhe je në moshën 86 vjeçare, je i lodhur e i dërmuar nga vitet e jetës e të vuajtjeve që t'i ka sjellur qëndresa përballë UDB-së dhe angazhimi Yt biblik e i pakursuer në shërbim të luftës për liri e çlirim të Kosovës nga Serbia pushtuese!

Për shkak të shëndetit Tënd të rënduar, mungesa e prezences Tënde fizike në çdo ngjarje që nderon jetën dhe veprën e figurës së madhe kombëtare e politike të Vëllaut Tënd gjigant, Heroit të Kombit Rexhep Malaj, por edhe të evenimenteve tjera kombëtare e shtetërore në Kosovë e jashtë saj, është boshllëk i madh për ata që dijnë dhe e njohin thelbin e historisë së madhe të luftës për largim të Serbisë pushtuese nga Kosova!

I dashur dhe shumë i nderuar Hasan Malaj,

Kam edhe shumëçka tjetër për të shkruar, por po e përfundoj me kaq, i bindur se ia kam arritur të shpreh pak nga respekti i madh i pakufishëm që ndjej per Ty në veçanti e per familjen Tënde në

përgjithësi!

I dashur dhe shumë i nderuar Hasan Malaj,

Me anë të kësaj letre publike të uroj jetë të gjatë e të lumtur në vitet në vazhdim kudo që të jeshë në Kosovë e jashtë saj!

Edhe kur mungon prezenca Jote fizike kudo ku nderohet gjaku i derdhur për liri, lufta e përpjekjet lridashëse e çlirimtare të Kosovës, jemi me Ty, të pershendesim e të përqafojmë, të qëndrojmë mbi supe, sepse jemi rritur e jemi burrrëruar me historinë dhe qëndresën titanike të Vëllaut Tënd legjendë e të Udhëheqësit tonë të madh e të lavdishëm, Heroit të Kombit Rexhep Malaj!

Dije dhe mos e harro kurr Ti dhe pjestarët e famalijes Tënde heroike të Malajve të mëdhenj e të panënshtuar, se jeni të admiruar e të respektuar kurdo e kudo në çdo pëllëmbë të Atdheut tonë!

Me shumë respekt,


Ismet SYLEJMANI,
Ish - antar i Kryesisë së Këshillit të Rrethit për Anamoravë të LPK-së, Ish - Antar i Komitetit Drejtues të LPK-së,

Ish - Antar i Shtabit të ZOK të UÇK-së,

Ish - Zëdhënës i Zonës Operative të Karadakut të UÇK-së!

Ish - Zëdhënës i Zonës së 6-te të TMK-së!

Prishtinë, 21 Janar 2026!



“PRISHTINA 2030” SJELL RISI NË LOJËRAT MESDHEKARE ME SPORTE TË REJA

PRISHTINË, 21 JANAR - Lojërat Mesdhetare “Prishtina 2030”, edicioni i 21-të i kësaj ngjarjeje sportive ndërkombëtare që do të zhvillohet në Kosovë dhe Shqipëri do të përfshijë një program të gjerë sportesh me 24 sporte të planifikuara të garës. Kjo listë përbëhet nga sporte të njohura ndërkombëtarisht, përfshirë si disiplina tradicionale olimpike ashtu edhe disa të reja për lojërat. Në “Prishtina 2030” do të garohet në sportet si: atletikë, boks,

xhudo, karate, peshëngritje, mundje, noti, polo në ujë, noti me vela, lundrim, qitje, pingpong, tenisi, volejboli, hendbolli, basketbolli 3x3, skermë, çiklizëm (rrugë dhe mountain bike), gjimnastikë (artistike dhe ritmike), badmintoni, karate, taekwondo, sportet e peshëngritjes, dhe sporte të tjera si futsalli, i cili është përfshirë zyrtarisht dhe do të zëvendësojë futbollin tradicional për U21 në këtë edicion.

Përveç sporteve kryesore, Komiteti Organizues ka rezervuar mundësinë e shtimit të dy apo tri sporteve shtesë, si Baseballi, Canoe Sprint, Kikboksi ose sporte me patina, në varësi të propozimeve që do të pranohen më vonë. Ky program shumëdimensional përfaqëson një nga ofertat më të gjera sportive në historinë e Lojërave Mesdhetare dhe çon përpara vizionin e organizatorëve për një ngjarje gjithëpërfshirëse dhe dinamike sportive.



LLAPI SHET NJË TJETËR FUTBOLLIST, ARDIT TAHIRI KALON TE KOLOS KOVALIVKA



PODUJEVË, 21 JANAR - Futbollisti Ardit Tahiri është bërë me skuadër të re gjatë afatit kalimtar të janarit. Skuadra e Superligës së Kosovës përmes rrjeteve sociale ka njoftuar publikun se Tahiri është transferuar te skuadra ukrainase, Kolos Kovalivka. “KF Llapi njofton opinionin publik dhe tifozët se ka arritur marrëveshje me

klubin Kolos Kovalivka për transferimin e futbollistit Ardit Tahiri. Marrëveshja e arritur mes dy klubeve është e favorshme për KF Llapi edhe në aspektin financiar, ndërsa klubi ynë do të mbajë 25 për qind të kartonit të lojtarit, si pjesë e marrëveshjes për një transferim të ardhshëm të mundshëm”, ka njoftuar KF Llapi. Te ekipi ukrainas luan edhe

ish-lojtari tjetër i Llapit, dhe përfaqësuesi i Kosovës, në fazën e mbrojtjes, Ilir Krasniqi. Ardit Tahiri ka qenë një nga futbollistët më të rëndësishëm të ekipit tonë në Superligën e Kosovës, duke u renditur në top 10-shen e golashënuesve më të mirë në historinë e klubit në elitë. Gjatë paraqitjeve të tij me fanellën bardhekaltër, Tahiri

ka zhvilluar 44 ndeshje zyrtare, në të cilat ka realizuar 19 gola dhe ka kontribuar me 4 asistime. Në pjesën vjeshtore të sezonit aktual, futbollisti ishte i huazuar te klubi HJK Helsinki, ku ka fituar përvojë të rëndësishme ndërkombëtare. Javën e kaluar nga skuadra është larguar kapiteni Axel Gnapi në drejtim të kampionatit rus.

VINICIUS HYN NË TOP 10 ASISTUESIT MË TË MIRË NË HISTORINË E LIGËS SË KAMPIONËVE



MADRID, 21 JANAR - Real Madrid ka dhuruar një mbrëmje spektakolare në “Santiago Bernabeu” me fitoren bindëse 6-1 ndaj Monacos, por vëmendja kryesore e ndeshjes ishte te Vinicius Junior. Ylli brazilian ishte protagonist absolut, duke realizuar një gol dhe duke dhënë dy asistime, në një paraqitje që ka konfirmuar edhe një herë statusin e tij si një nga lojtarët më vendimtarë të futbollit

evropian. I vërsëlltë fillimisht nga një pjesë e tifozëve, Vinicius ka arritur t'i kthejë fishkëllimat në duartrokitje përmes lojës së tij elektrizuese dhe ndikimit direkt në rezultat. Përveç kontributit vendimtar në fitoren e thellë, 23-vjeçari ka shënuar edhe një arritje historike personale. Me dy asistimet kundër Monacos, Vinicius Junior ka arritur kuotën e 30 asistimeve në Ligën e Kampionëve, duke u

ngjitur në vendin e tetë në renditjen e asistuesve më të mirë të të gjitha kohërave në këtë kompeticion prestigjioz. Ngjitja e Vinicius Junior në këtë listë elitare dëshmon jo vetëm talentin e tij individual, por edhe pjekurinë që ka fituar vitet e fundit në fanellën e Real Madridit. Me ritmin aktual dhe moshën e re që ka, braziliani ka të gjitha mundësitë që në vitet në vijim të ngjitet edhe më lart në këtë renditje historike.

TOP 10 ASISTUESIT MË TË MIRË NË HISTORINË E LIGËS SË KAMPIONËVE:

Cristiano Ronaldo - 42 asistime
Angel Di Maria - 41 asistime
Lionel Messi - 40 asistime
Neymar - 33 asistime
Kevin De Bruyne - 31 asistime
Ryan Giggs - 31 asistime
Xavi Hernandez - 30 asistime
Vinicius Junior - 30 asistime
Thomas Muller - 30 asistime
Karim Benzema - 29 asistime


Zyrtare: Ter Stegen huazohet te Girona

Girona, 21 janar - Girona FC ka konfirmuar zyrtarisht marrëveshjen e huazimit me FC Barcelona për portierin Marc-Andre ter Stegen, i cili do të mbrojë portën bardhekuqe deri në fund të sezonit aktual. Portieri gjerman transferohet te Girona pas humbjes së rolit të tij kryesor te Barcelona, në

një përpjekje të qartë për të siguruar minuta të rregullta loje dhe për të qenë pjesë e Kombëtares së Gjermanisë në Kupën e Botës. 33-vjeçari e ka nisur karrierën në akademinë e Borussia Monchengladbach, ku debutoi në Bundesliga në moshën 18-vjeçare. Falë pjekurisë dhe qëndrueshmërisë së tij, ai u

konsolidua shpejt si një nga portierët më premtues në Gjermani, përpara se t'i bashkohej Barcelonës në vitin 2014. Gjatë periudhës së tij te klubi katalanas, Ter Stegen ka zhvilluar 423 paraqitje zyrtare, duke fituar një Ligë të Kampionëve, gjashtë tituj të La Ligës, gjashtë Kupa të Mbretit, një Superkupë

Evropiane dhe një Kupë Bote për Klube. I vlerësuar gjerësisht si një nga portierët më të mirë në botë, Ter Stegen shquhet për stilin e tij modern të lojës: shpërndarje të shkëlqyer me këmbë, reflekse të shpejta, pozicionim të sigurt, dominim në lojën ajrore dhe inteligjencë të lartë taktike.



NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “ALLER” SH.P.K. pronar Florent Buca me seli në Gjilan, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 812188474 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “ALLER” D.O.O. Florent Buca Gnjlane donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812188474 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “ALLER” L.L.C. with owner Florent Buca with headquarters Gjilan, has come to the decision to quit its business: 812188474 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “ByteBuilders” SH.P.K. me seli në Fushë Kosovë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 812041226 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “ByteBuilders” D.O.O. Kosova Polje donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812041226 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “ByteBuilders” L.L.C. with headquarters Fushë Kosovë, has come to the decision to quit its business: 812041226 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Fitim Gërbeshi shpall të pavlefshme dëftesat si dhe diplomën e shkollës së mesme “Shtjefën Gjeçovi” Prishtinë.

- Ferdonije Shllaku shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. ekonomike “Kadri Kusari” Gjakovë.

- Luan Alijaj shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

- Agim Leka shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

- Berat Kasapi shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 të gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

- Gentian Muhadri nga Damjani KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e plotë sh.f.m.u. “Pjeter Bogdani” Damjan Gjakovë nga kl. I-V dhe VI-IX.

- Krenar Abrashi shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit “Krenar Abrashi” B.I. me nr. Unik: 811133719.

- Fitore Rexhepi shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “Fazli Greiçevci”.

- Maurita Koca nga Bishtazhini KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të Gjimnazit “Hajdar Duishi” Gjakovë.

- Bedri Zeneli nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën dhe certifikatën e notave të Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, “Dino Mineral” Sh.p.k. Lipjan në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Pëlqim Mjedisor, për përpunimin, thërrmimin dhe seperimin e gurit gëlqeror të mermerizuar në Koretishë - Novobërdë.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 12.03.2026 në ora 11:00 në SHFMU “Minatori” në Novobërdë, do të organizohet debat publik nga “Dino Mineral” Sh.p.k. Lipjan, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën online:

<https://us05web.zoom.us/j/7012651943?pwd=JsyiMPR68pjZDwwrm2Z53eU1x9TEbu.1>

Meeting ID: 701 265 1943

Passcode: 123456

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për “Dino Mineral” Sh.p.k. Lipjan - për përpunimin, thërrmimin dhe seperimin e gurit gëlqeror të mermerizuar në Koretishë - Novobërdë.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin

vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, “Dino Mineral” Sh.p.k. Lipjan në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Pëlqim Mjedisor, për Bazën e prodhimit të betonit në Koretishë - Novobërdë.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 12.03.2026 në ora 10:00 në SHFMU “Minatori” në Novobërdë, do të organizohet debat publik nga “Dino Mineral” Sh.p.k. Lipjan, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën online:

<https://us05web.zoom.us/j/7012651943?pwd=JsyiMPR68pjZDwwrm2Z53eU1x9TEbu.1>

Meeting ID: 701 265 1943

Passcode: 123456

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për “Dino Mineral” Sh.p.k. Lipjan - për Bazën e prodhimit të betonit në Koretishë - Novobërdë.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin

vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, “Dino Mineral” Sh.p.k. Lipjan në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Pëlqim Mjedisor, për Bazën e prodhimit të asfaltit në Koretishë - Novobërdë.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 12.03.2026 në ora 09:00 në SHFMU “Minatori” në Novobërdë, do të organizohet debat publik nga “Dino Mineral” Sh.p.k. Lipjan, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën online:

<https://us05web.zoom.us/j/7012651943?pwd=JsyiMPR68pjZDwwrm2Z53eU1x9TEbu.1>

Meeting ID: 701 265 1943

Passcode: 123456

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për “Dino Mineral” Sh.p.k. Lipjan - për Bazën e prodhimit të asfaltit në Koretishë - Novobërdë.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin

vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

NJOFTIM

Në bazë të Ligjit për shoqëritë tregtare Ligji Nr. 06/L -016, konform nenit 112 paragrafi 1,2,3,4 njoftojmë të gjithë furnitorët dhe klientët si dhe personat tjerë juridik dhe fizik se Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar Market Te Fanoli SH.P.K. me numër unik identifikues (NUI) : 812120442 me seli Rruga Agim Ramadani, nr.10 Komuna: Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin dhe ka caktuar likuidatorin Melihate Kaçiu me ID: 1173763740 me vendbanim në me adresë: Komuna: Podujevë, Vendi: Podujevë, Adresa: Lupç i Poshtëm me tel: 045/283-748 për zhvillimin e procedurës së Likuidimit.

Njoftohen të gjithë furnitorët dhe klientët si dhe personat tjerë juridik dhe fizik që kanë interesa të parealizuara dhe raporte Kreditore-Debitore në këtë shoqëri që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

MEKA
®
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992







ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

